



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-29266/24
Kaçanik, 18.11.2024

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2024.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 26.11.2024 (e Martë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të KPF-s të datës 26.11.2024, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025;
3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 060/01-26543/24
Kaçanik, 21.10.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX (nëntë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VIII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 21.10.2024, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00. Nga përbërja e përgjithshme e KPF, pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, ndërkaq në mbledhje nuk është ftuar anëtarja e re e emruar nga AAK- Edona Luzha, për shkak se nuk është konfirmuar ende nga MAPL vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të KK për emërimin e saj.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari-Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Ramadush Osmani-DSHPE, Suhad Dullovi-DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP. Nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Festim Neziraj, Maviye Murseli, Makfire Malsiu.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësi, konstatoi kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të KPF-së për vitin 2024, data 21 tetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti nëntëmujor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024;
3. Raporti i Përfundimit komunal për vitin 2023;
4. Informatë për përfundimin e Vitit Shkollor, 2023-2024;
5. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

znj. Ardita Rrahmani: I falënderoj zyrtarët për punën e bërë, se nuk është e lehtë me mbajtur procesverbal, gabimet mund të ndodhin, se është e pamundur me u përfshirë çdo fjalë, ka diku që janë ndryshuar fjalët e mia, e njëjta është edhe në KK, por me rëndësi është mos t'i humb kuptimi fjalisë. Këtë herë lë të kalohet kështu procesverbali, për hera tjera me pasur kujdes.

Kryesuesi i Kuvendit: Është edhe incizimi i mbledhjes. Procesverbalin e mbledhjes se kaluar të KPF e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri pa vërejtje konkrete. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VIII (tetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 24.09.2024/ Lënda: 01Nr.060/01-23027/24.

2. Raporti nëntëmujor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, para se me marrë fjalën drejtori, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Raportin nuk e kam marrë me materialet të KPF, me ato të KK e kam marrë. Të raporti financiar është bërë një përmbledhje e të hyrave dhe shpenzimeve për 9 muaj. Buxheti i miratuar është 11,958,983.€00€, buxheti i tanishëm 13,348, 458.76. Të HVK thuhet janë bartë 1 milion e 98 mijë, 230 mijë i kemi bartë me KK, 867 mijë janë HVK janë bartë nga v.2023 në vitin 2024. E kemi granti e përfiormancës, ndërkaq me intereson të di, çka janë donatorët e jashtëm, kërkoj sqarim për shumën 292 mijë euro. Të shpenzimet janar- shtator, e keni cekur shpenzimet e buxhetit aktual, e jo buxheti i miratuar. Në buxhetin aktual, a kemi rezervë 25mijë euro të hyra aktuale që i kemi bartë. Të Mallrat dhe shërbimet, shërbimet këshilluese profesionale të administratës 11 mijë euro. Të mirëmbajtja rutinore, nëse mundeni me shpjeguar për çka janë shpenzuar mjetet dhe të mirëmbajtja e rrugëve. Të subvencionet dhe transferet, shpenzimet për 9 muaj janë 450 mijë euro, ndoshta është bërë gabim teknik, ndërsa në total janë 247 mijë euro. Të IK, jeni thirrur në buxhetin e planifikuar, a keni planifikuar që do t'i merrni donacion 286 mijë euro ? Të mjetet e Granti i Përformancës-GP, 286 mijë euro i keni cekur se janë ndarë për ndërtimin e parqeve publike në Kaçanik të Vjetër, Izolim i jashtëm dhe zbatim i masës efecientë të shkolla " Nazmi Osmani", dhe Ndërtimi i trotuarit të rrugës regjionale" Ahmet Kaçiku" janë shpenzuar 55 mijë euro, ndërkaq janë edhe 230 mijë euro tjera të pashpenzuara. Nëse mundeni me na shpjeguar për mjetet e lira, a janë kategorizuar diku apo janë mjete të lira, se jeni thirrur në buxhetin e planifikimit, jo në buxhetin aktual? Të ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik në rrugën "Fadil Bunjaku", 5 mijë euro, këtu janë kryer procedurat e prokurimit. Rregullimi dhe rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Kaçanik i Vjetër-Stagovë-Runjevë, janë vetëm 5 mijë euro, a keni mjetet tjera për këtë projekt apo jo, se ky projekt është në proces të prokurimit apo i ka kaluar fazat e prokurimit, e keni shënuar në buxhet të planifikimit, i keni planifikuar 4 milion e 296 mijë euro, nuk është e vërtetë se janë planifikuar kaq dhe mundemi me thënë se buxheti është planifikuar kaq dhe buxheti aktual është kaq, se të planifikuara kanë qenë mbi 3 milion euro.

z. Bahri Selimi: Planifikimi i buxhetit për subvencione dhe transfere janë 450 mijë, ndërsa shpenzimet janë 87 mijë, janë të shënuara me poshtë shpenzimet.

znj. Ardita Rrahmani: Shqetësuese është planifikimi në raport me realizimin, sidomos të DBF, ku planifikimi ka qenë mbi 546 mijë euro, ndërsa realizimi për 9 muaj mbi 300 mijë euro, apo 57%. Shpresoj realizimi do të bëhet në harmoni me planifikimin. P. sh. taksat për leje komunale për leje ndërtimi, të planifikuara 190 mijë euro, realizimi është vetëm 26 mijë euro. Të taksat tjera administrative, planifikimi 1000 euro, realizimi 65 mijë euro. Kjo lënë për të dëshiruar mënyrën sesi planifikohet një buxhet. Pyetja është: Pse ka ndodhë kjo?

z. Agim Mani: Të të HVK, buxheti i miratuar është 924 mijë euro, ndërsa buxheti i tanishëm, 924 euro.

Kryesuesi i Kuvendit: Të çështja e të HVK, në mungesë të PZHK kanë munguar edhe dhënia e lejeve të ndërtimit. Të tatimi në pronë, ka pasur ndërhyrje nga niveli qendror të falja e tatimit. Me planifikim nuk kemi me qenë mirë sivjet, se kanë ndodhur çështje që nuk i kemi planifikuar, se kemi menduar që kryhen disa çështje, por nuk janë kryer.

znj. Ardita Rrahmani: Është mirë me ditur se në vitin tjetër ka me u ngritur TP, qysh ka ndikuar të ne kjo ngritje, dhe ne kemi me u ballafaquar edhe me një problem tjetër, se është fushatë zgjedhore.

Kryesuesi i Kuvendit: Ndryshohen këto, është një nivel tjetër që vendosë, ndërkaq ne vendosim brenda minimumit dhe maksimumit të asaj, dhe normal edhe normat tatimore e ndryshojnë buxhetin për vitin vijues.

z. Bahri Selimi: Foli për mjetet e të HVK të cilat nuk janë inkasuar, si çështja e mjeteve nga TP dhe ato të lejet ndërtimore. Këto të lejet ndërtimore janë inkasuar me pak, si rezultat i mungesës së PZHK. Të hyrat administrative, janë disa të hyra të cilat nuk janë selektuar.

Kryesuesi i Kuvendit: A janë këto të hyra në harmoni me Rregulloren për taksa dhe pse nuk emërtohen këto tarifa?

z. Bahri Selimi: Po janë, por çështja është se janë do punë teknike administrative që ende nuk janë duke i kryer mirë zyrtarët.

znj. Ardita Rrahmani: Kush duhet me ua tërhequr vërejtjen për një punë që nuk kryhet mirë?

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë për këtë temë edhe në vitin e kaluar në vazhdimësi e kam pyetur drejtorin, na është thënë se ka me u rregullua, por nuk janë rregullua ende. A ka ndonjë datë të caktuar që ka me u rregullua? Nëse një qytetar e bënë një pagesë për një kërkesë të caktuar, a i figuron aty se për çfarë kërkesë është duke paguar? Duhet me pasur një kod dhe një emërim, se edhe në bankë kur bëhen pagesat në UNIREF, kategorizohen.

z. Bahri Selimi: Po kanë, ne mundemi me lëvizë me planifikim, por ne mundemi me pasur edhe të hyra tjera, se krejt ato të hyra për një vit nuk munden me qenë mbi 1000 euro. Kur jemi të buxheti i miratuar dhe buxheti aktual, buxheti miratohet në shtator, ndërkaq lëvizjet mund të ndodhin gjatë kohës, si bartja e të hyrave nga vitet e kaluara. Të pyetje për mjetet nga donatorët, shuma mbi 286 mijë euro të lista e projekteve janë pranuar prej MAPL dhe DEMOS për grantin e performancës. Këtu ka ende mjete, faturën e paguan direkt MAPL, ndërsa DEMO na i procedon mjetet në llogarinë tonë, vetëm mbi 5678 euro janë të bartura nga fondi i vitit të kaluar.

z. Agim Mani: Qysh janë bartur kjo shumë e fondeve buxhetore? Kur është bartë të HVK janë cekur edhe të hyrat nga donacionet, shuma 5678 euro nuk është bartur, në kohë.

z. Bahri Selimi: Janë me marrëveshje të bashkëfinancimit, DEMOS, MAPL, Kryetar. Mjetet procedohen direk në buxhet. Shuma 5678 euro nuk është nga të HVK dhe nuk është bartur, mjete dalin në llogari të komunës me 1 janar të vitit vijues nëse nuk janë shpenzuar.

znj. Kadrije Lika-Troni: A munden me u shpenzuar këto mjete për ndonjë projekt, nëse ekziston projekti i gatshëm?

z. Bahri Selimi: Po munden, por duhet me pasur marrëveshje.

z. Agim Mani: Një pyetje e pata me herët të rezerva komunale, kërkoj përgjigje.

z. Bahri Selimi: Po munden, rezerva ka qenë prej fillimit pjesë e buxhetit të miratuar, këto mjete 25 mijë euro nga 1 tetori kanë dalë në projektin “Rregullimin e trotuarit të rrugës ” Fadil Bunjaku” në Biçec. Kontrata është lidhur, rezerva pastaj u zhdukur. Të MSH të shërbimet këshillëdhënëse, të DAP janë paguar administratorët e fshatrave. Të mirëmbajtja rutinore, kemi bërë një përshkrim të kësaj, është të DSHPE ky projekt, janë kryer pagesat për vitin 2023 shuma 2300 euro, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara, sipas marrëveshjes me KRM ‘Pastërtia’ afër 32 mijë euro, ndërkaq për sivjet janë paguar 22,526 euro, gjithashtu edhe pagesat për deponi ilegale.

z. Agim Mani: Sa është shuma e mjeteve të deponia ilegale të shpenzuara në këtë vit? Të mjetet për IK nga GP, a janë të zotuar, a kanë kod buxhetor, se e keni shënuar se janë mjete të lira, se me qenë të lira munden me u bartë kudo, ndërsa nëse nuk janë të lira, nuk munden me u bartur kudo.

z. Bahri Selimi: Të deponitë ilegale janë 22,526 euro, janë shpenzuar në këtë vit. Të Subvencionet dhe transferet, të planifikuara 450 mijë euro, janë shpenzuar 247 mijë euro. Të IK, granti i performancës janë mjetet e lira, janë të zotuar, por ende nuk janë të shpenzuara. Drejtori dha sqarime me shifra për shumën e mjeteve të shpenzuara nga GP dhe atyre të mbetura.

z. Agim Mani: Të rregullimi dhe asfaltimi i rrugës: Gërlicë-Stagovë, janë të koduara 5 mijë euro, faza e tenderit ka përfunduar, ku i keni marrë mjetet? Mjetet 230 mijë euro nuk janë të lira, por janë të koduar në këtë projekt.

z. Bahri Selimi: Ne e kodojmë projektin me 5 mijë euro, projekti është financuar nga GP dhe një nga projekti i ministrisë së financave. Shuma 341 mijë euro i mbulojmë marrëveshjet për bashkëfinancim.

Kryetari i Komunës: Projekti është financuar nga GP në bashkëfinancim me ministrinë e Financave.

z. Ramadush Osmani: Jep sqarimin se kemi të bëjmë me një trase me dy projekte. Në tender që po e përmend Agimi, është asfaltimi i rrugës: Runjevë-Stagovë, e cila financohet nga MAPL me bashkëfinancim, është i koduar në ministri, sepse edhe ata hapin kode buxhetore, ndërsa kjo tjetra, 5 mijë euro ka të bëjë me një projekt tjetër, është pjesa Runjevë-Stagovë që bashkë financohet me këto kodet dhe mos u thirrur në këtë shumën 5 mijë euro, se nuk kemi zhvilluar procedura të prokurimit.

Kryetari i Komunës: Projekti është Runjevë-Stagovë deri në Gërlicë, mjetet janë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nëse ministria formon kode në vete, atëherë pse me lënë ne kode me nga 5 mijë euro?

z. Bahri Selimi: Mirë e keni Kadrije, kemi filluar me i hequr këto kode buxhetore nga 5 mijë euro. Kur e kemi miratuar buxhetin e vitit 2025, e keni pa se nuk ka shumë kode, ndërsa ka qenë praktikë me herët se u dashke me lënë kode buxhetore me nga 5 mijë euro. Ne tani kemi filluar me iu përshtatur ndryshimeve.

z. Rustem Zenuni: A ka një plan të ndarjeve buxhetore se ku kanë shkuar mjetet nga GP. Të taksat administrative, është mirë drejtor nëse ka mundësi me na dërguar saktë se për cilat pagesa është fjala. Unë po besoj se janë krejt në rregull, por kur kërkohet me shumë përgjegjësi, edhe zyrtarët tregohen me të kujdesshëm. Lë të jetë e fundit që këto taksa na dërgohen në këtë formë, por edhe atyre zyrtarëve poshtë, lë të qartësojnë me tepër këto taksa, lë t’ua dërgojnë me komente, për me qenë me të qarta.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK për shqyrtim. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi që KPF, **shqyrtoj Raportin nëntëmuor financiar për periudhën, Janar-Shtator 2024. Ky raport financiar i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.**

3. Raporti i Përformancës komunale për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, ne këto raporte i sjellim në KK sa për informacione. Përformanca bëhet nga MAPL. Shpesh herë në raporte kemi edhe vërejtje, nuk e di a është faji i zyrtarëve tonë, apo i atyre të MAPL që nuk i përfshijnë të gjitha të dhënat në raport. Si komunë qëndrojmë bukur mirë me raport të përformancës. Ne e patëm edhe një debat me Jeta Xharra e cila u thirrte pikërisht në këtë raport, ajo i përmende vetëm fushat dhe treguesit ku kishte ngecje. Raport përbëhet prej 16 fushave, me 82-83 treguesve. Kur e përmenda se ka ngecje raporti, po e përmendi një fakt, jemi me 0 pikë për diskutim të raportit të auditorit komunal, ndërsa krejt jemi dëshmitarë se u diskutua në KK Raporti i auditorit. Ne nuk është dashur me u pajtuar me 0 pikë, për një çështje që e kemi diskutuar. Tjetër, është prezenca e kryetarit në mbledhje të KK. Kryetari ka marrë pjesë në gjitha mbledhjet e KK. Ne edhe pa këto rangime jemi mirë si komunë. Të transparenca që po na akuzoni shpesh, kemi vlerësim 100%.

znj. Kadrije Lika Troni: Të transparenca komunale, kërkesat të cilat i bëjnë qytetarët me shkrim, sa është transparente drejtoria, a shqyrtohen me kohë, a i bien dikujt me prituri shumë? Kërkesat e qytetarëve nuk po shihen, po janë në sirtar të pritjes. Qysh me ditur se u shqyrtua një kërkesë? Kur bëhet një kërkesë, nuk formohet as komision me dal në terren, përgjigja deponohet me shkrim poshtë, ndërkaq pala nuk merr me shkrim kurrfarë përgjigje. Sa janë transparente kërkesat?

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di si trajtohen në aspektin administrativ, por sa di unë çdo kërkesë e qytetarëve adresohet përmes administratorëve. Kërkesat që vinë nga këshillat lokale të fshatrave, bëhen publike. Kërkesa e qytetarëve janë të llojllojshme, ndërsa ato që shkojnë përmes këshillave lokale, besoj se janë të regjistruara të gjitha, janë edhe përmes debateve publike, janë procesverbalet. Të thuash se duhet të publikohen të gjitha, besoj se këtë e dini edhe ju se nuk publikohen, se kërkesat janë të natyrave të ndryshme, si për çështje të ndihmave sociale, kështu që çdo kërkesë që kanalizohet, besoj se regjistrohen. Sa i përket kërkesave individuale, ka shumë kërkesa dhe nuk është në rregull me i publikuar.

znj. Kadrije Lika Troni: Kur është në pyetje një lagje, drejtoria përkatëse nuk formon as komision për me dal në vendngjarje, bile as përgjigje nuk kthen. Së paku me informua se deri ku ka arritur kërkesa, se telefonat i keni pa para, kështu që me njoftuar palën?

Kryesuesi i Kuvendit: Është afati ligjor për përgjigje. Nëse kërkesa është adresuar përmes këshillit lokal, është në obligim ligjor me kthyer përgjigje brenda 30 ditëve, qoftë pozitiv apo negativ, ndërsa a i përmbahet apo jo afatit ligjor, ajo është çështje tjetër.

znj. Dardana Tafili- Dauti: Të gjitha kërkesat që adresohen në zyrën e pranimit poshtë, e kanë afatin ligjor të shqyrtimit, pavarësisht negativ apo pozitiv, kjo është në obligim të secilit drejtor që i adresohet kërkesa.

z. Qamil Stagova: Para 2 muajve lagjja Kovaçec e ka bërë një kërkesë, sipas të cilës një pjesë të pronës private donë me bërë pronë publike. Ne nuk kemi arritur me futur në prioritet për

sivjet, nuk kemi kthyer përgjigje. Nuk kam mundur me përcaktuar se në cilën periudhë ka me u kryer që me ia kthyer një përgjigje.

znj. Kadrije Lika Troni: Pavarësisht, një përgjigje është dashur me ia kthyer.

z. Rrustem Zenuni: Unë në raportin e punës së ekzekutivit kur të na vjen, e shoh p.sh. të DSHPE, shumë lagje adresojnë kërkesa, përgjigjet ju epën. P.sh. një lagje ka kërkuar 50m gyp apo zhavorr, në raport të ekzekutivit e kam pa se ju epët përgjigje. Nuk e di sa qytetarët bëjnë vizita lagjes se a kanë marrë përgjigje në kërkesa?

znj. Kadrije Lika Troni: Pyetjen që e bëra unë, drejtori e dha përgjigjen shumë mirë dhe ishte i arsyeshëm dhe i kuptueshëm. Për pyetjen time, nuk ka nevojë me tepër për sqarime.

z. Rrustem Zenuni: Jo vetëm për pyetjen e juaj, por për shumë pyetje tjera, unë e kam pa se në raport tregojnë se ju kanë dhënë përgjigje dhe besoj se në këtë aspekt jemi në rregull.

z. Agim Mani: Unë dy pyetje i kam bërë, nuk kam marrë përgjigje.

znj. Ardita Rrahmani: Të poentimi kur bëhet për formimin e këshillave lokale, poentimi është 50.3. po me intereson të di pse ky poentim, se sa e di unë janë vetëm 2 lokalitetet ku nuk janë formuar këshillat lokale. Është mirë kryetari dhe drejtoresha me insistuar edhe në ministri pse me u bërë kjo, se në fund të fundit ne po ndëshkohemi si qytetarë për shkak të këtij poentimi.

Kryesuesi i Kuvendit: Në raportin e performancës ka edhe tregues që si komunë po ndëshkohemi padrejtësisht. Të barazia në punësim, ne jemi shumë keq, nuk me është dhënë fjala edhe në debatin me Jetën, se barazia në punësim, është sa anëtarë të komunitetit i kemi të punësuar në komunë. Ne nuk kemi asnjë, se nuk kemi komunitete. Në këtë drejtim ne nuk po marrim pikë padrejtësisht. Ne jemi duke punuar me MAPL që disa tregues me i ngritur se nuk iu kanë përshtatur shumë komunave, se ne nuk mundemi me plotësuar këtë tregues se nuk kemi komunitet të tillë.

znj. Ardita Rrahmani: A është diskutuar kryesues kjo çështje në asociacion?

Kryesuesi i Kuvendit: Po.

Kryetari i Komunës: Këto padrejtësi që na janë bërë, si çështja e raportit të auditorit, të pjesëmarrja e kryetarit në mbledhje të KK, mirëmbajtja e rrugëve, del vlerësimi 0. Ne i kemi përcjellë si komente, por çështja është se nuk kanë intervenuar fare, na e kanë përcjellë raportin pa përgjigje. E vetmja rrugë është me i paditur në gjykatë.

znj. Ardita Rrahmani: Me ndenjur pasiv kundër kësaj padrejtësie, mua nuk po me duket në rregull.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Grupi punues që është punuar me punuar në këtë drejtim, secili e ka kryer punën e vet. Kemi marrë edhe këshilla prej MAPL ku ka pasur nevojë për korrigjime dhe shtim të dokumentacionit. Pas kësaj faze, janë verifikuar edhe mostrat që i ka vendosur grupi punues në secilin dokument veç e veç. Pas raportimit, ka ndodhë që MAPL ka dal edhe në terren për me vërtetuar se a janë të dhënat e raportuara reale. Pas krejt kësaj, ka tregues që janë vlerësuar me 0 pikë, kjo nuk është reale. Për këtë koordinatori me grupin punues kanë bërë ankesë duke ia bashkangjitur edhe dokumentet përkatëse për aty ku jemi vlerësuar me 0 pikë, mirëpo ankesa është refuzuar. E vetmja zgjidhje është ne me bërë padi në gjykatë.

Kryetari i Komunës: Në terren nuk kanë ardhur fare sivjet me vërtetuar gjendjen. Në vitin e kaluar kanë qenë e kanë vërtetuar gjendjen. Të debatet për buxhet, ne e kemi një mostër prej DEMOS qysh me kthyer përgjigje, e kemi kthyer, na ka ardhur vlerësimi 0. Ne e kemi bërë koment, ndërkaq na e kanë kthyer negativ, pa asnjë koment.

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti i punës së KK për vitin 2023 është i protokolluar dhe nënshkruar, publikuar, ndërkaq vlerësimi është me 0 pikë.

Kryetari i Komunës: Për dokumentet të cilat nuk i kemi pasur, si Raporti i vlerësimit në mjedis, planit të transportit të cilat i miratuar në mbledhjen e KK, nuk i kemi pasur, jemi pajtuar me 0 pikë, ndërkaq për ato të cilat i kemi pasur dhe jemi vlerësuar me 0 pikë, nuk jemi pajtuar, ua kemi përcjellë me linke të gjitha, por nuk kanë dhënë asnjë koment. E kemi ngritur si shqetësim komunat këtë çështje, që për vitin vijues me pasur vlerësim për dokumentet që janë.

Kryesuesi i Kuvendit: Vlerësimi duhet me qenë korrekt, e jo pikërisht në ato pikë që ne qëndrojmë mirë, me u vlerësuar me 0 pikë. Transparencën e vlerësojnë me 0 pikë. Jam i bindur se nuk ka komunë në Kosovë që e ka transparencën 100%, e vlerësohem me 100 pikë. Ndërkaq një çështje që shumë lehtë mundemi me vërtetuar, Raportin e punës së KK, është i publikuar, ndërkaq në raport thuhet se nuk e keni dhe vlerësohem me 0 pikë. Krejt procesverbalet i ka MAPL të punës së KK. A jeni që kjo pikë t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. **Në saje të kësaj del konstatimi KPF shqyrtoj Raportin e Përformanës komunale për vitin 2023. Ky raport i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim.**

4. Informatë për përfundimin e Vitit Shkollor, 2023-2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori nuk qenka këtu, nëse nuk keni diçka me diskutuar, diskutojmë në KK. a jeni t'i shkoj KK kjo informatë? Njëzëri u pajtuan të gjithë. **Në saje të kësaj del konstatimi se KPF, Informatën për përfundimin e vitit shkollor 2023-2024, ia kalon KK në procedurë për shqyrtim.**

5. Propozim Vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë ka pasur mundësi mos me ardhur fare në KPF. E hap diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë të shkoj në KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit 01Nr. 104/02-4209/22 të datës 28.02.2022 për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NKP “Stacioni i Autobusëve” Sh. A. Kaçanik. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

z. Agim Mani: Kërkoj sqarime për mbledhjen e jashtëzakonshme, e cila është ftuar për nesër.

Kryesuesi i Kuvendit: Për shkak të ndërhyrjeve në sistemin e pagave nga përmblyesit privat që po ndodhin për shkak të kontratës kolektive, ministria e Financave e ka njoftuar drejtorin e financave se duhet me bërë korrigjime buxhetore. Drejtori nuk ka mundur me lënë korrigjimet

buxhetore për mbledhje të rregullt, sepse rrezikohemi me pagat sikurse disa komuna, është thirrë mbledhja e jashtëzakonshme me i aprovuar korrigjimet buxhetore.

Kryetari i Komunës: Për mos me u rrezikuar pagat dhe mos me na u marrë mjetet ata ku duan, se është një organizatë buxhetore, i kemi propozuar këto ndryshime buxhetore.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:53. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët sa ishin prezentë - 06.

Mbledhja e 10 e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 30.10.2024, në ora 11:00, ndërkah me 22.10.2024 do të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e KK në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik / Municipality of Kaçanik



01 Nr. 060/01-28018/24
Kaçanik, 04.11.2024

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në pajtim me nenin 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Kuvendit të Komunës,

PROPOZON

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E SHKALLËVE TATIMORE PROGRESIVE NË PRONËN E
PALUAJTSHME PËR VITIN 2025**

Neni 1

Shkallet tatimore progresive

1. **Cakton** shkallët tatimore progresive për vitin 2025 për vlerat e pronave në teritorin e Komunës së Kaçanikut, sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:
 - 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
 - 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni, **caktohet**;
 - 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
 - 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni dhe
 - 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa –Sektori për Tatim në Pronë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe fillon të zbatohet nga 1 janari 2025.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 i riformuluar me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20 e datës 16 gusht 2023 ,të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut.

Me dispozitat e cekura ligjore përcaktohet që Kuvendi i Komunës cakton shkallën e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit.

Nga të cekurat më lartë propozohet miratimi i këtij Propozim-Vendimi.

KRYETARI I KOMUNËS





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-29265/24
Kaçanik, 18.11.2024

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (c) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës 01Nr. 6/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 15.1(c) lidhur me nenin 55 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës të datës 13.11.2008, Kryesuesi i Kuvendit bënë këtë:

PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me _____, 24, të merr këtë

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, në përbërje prej 7 anëtarëve, 6 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

1.1.	Kemal Murseli,	kryesues	KK
1.2.	_____	anëtar	KK
1.3.	_____	anëtar	KK
1.4.	_____	anëtar	KK
1.5.	_____	anëtar	KK
1.6.	_____	anëtar	KK
1.7.	Makfire Malsiu	anëtar	Zyra e Kryetarit.

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi do të hartoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025 dhe për të njëjtin do t'i zhvilloj procedurat e nevojshme sipas rregullave ligjore në fuqi deri me miratimin e planit nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit; Kryetari i Komunës; Arkivi.

